



Jeffrey C. Riley
Komisioneri

Departamenti i Masaçusetsit për Arsimin Fillor dhe Dytësor

75 Pleasant Street, Malden, Massachusetts 02148-4906

Telefon: (781) 338-3000

TTY: N.E.T. Relay 1-800-439-2370

Shtator 2023

Të nderuar prindër/kujdestarë të klasës së vitit 2027:

Nxënësit e ardhshëm të klasës së nëntë të këtij viti janë futur në shkollën e mesme në një kohë kur shteti po kalon standarde të reja për kërkesën e Përcaktimit të Aftësive (CD) në MCAS në artet e gjuhës angleze (ELA), matematikë dhe shkencë. Shpresoj që kjo letër do të ndihmojë për të sqaruar kërkesat e diplomimit për klasën e fëmijës suaj.

Në mbledhjen speciale të datës 15 gusht 2022, Bordi i Arsimit Fillor dhe Dytësor votoi për të përditësuar kërkesën CD duke filluar me klasën e vitit 2026. Standardi i ri përcakton rezultatet e reja kaluese në ELA, matematikë dhe shkencë për t'u diplomuar nga shkolla e mesme. Studentët në klasat e vitit 2026 deri në vitin 2030 duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme që të kenë të drejtën e diplomës së shkollës së mesme (përveçse të plotësojnë të gjitha kërkesat vendëse të diplomimit):

- të fitojnë një rezultat të shkallëzuar prej 486 ose më të lartë në provimet e ELA dhe të matematikë, ose në provimet e përsëritura të tyre; ose
- të fitojnë një rezultat të shkallëzuar prej 470-485 në provimet e ELA dhe të matematikës, ose në provimet e përsëritura të tyre, dhe të plotësojnë kërkesat e Planit të Aftësive Arsimore (EPP) në ato lëndë (www.doe.mass.edu/assessment/epp); dhe
- të fitojnë një rezultat të shkallëzuar prej 470 ose më të lartë në provimin e shkencës ose biologjisë ose në hyrjen në fizikë.

Studentët do të bëjnë provimet në ELA dhe matematikë në klasën e 10-të dhe kanë të drejtën të bëjnë një nga provimet e shkencës në klasën e 9-të ose të 10-të. Studentët do të vazhdojnë të kenë mundësi për të përsëritur provimin në provimet MCAS të shkollës së mesme dhe do të kenë mundësinë të kualifikohen për kredite shkollimi në një kolegji ose universitet publik të Masaçusetsit nëpërmjet provimeve MCAS të shkollës së mesme. Informacioni rreth bursave gjendet në www.doe.mass.edu/scholarships/mastery/koplik-adams-compare.html.

Nëse keni pyetje në lidhje me kërkesat e diplomimit, ju lutemi kontaktoni konsulentin ose drejtorin e shkollës suaj ose vizitoni www.doe.mass.edu/mcas/graduation.html për më shumë informacion.

Me respekt,

Jeffrey C. Riley
Komisioner i Arsimit Fillor dhe Dytësor